Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
Nr.Br.No. 01 / 770
DAT.DT. 23.12.20
PRISHTINË

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK. Nr. 283/2020
Datë: 21 dhjetor 2020

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.12, 1.14, 1.17, nenit 27 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 13 paragrafi 1 pika 1.1, nenit 18, 24 paragrafi 1 pika 1.3, neni 32 paragrafi 1 pika 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat, si dhe nenit 5, 12 dhe 14 të Rregullores Nr. 03/2019 për Organizimin dhe Funksionalizimin e Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit, në mbledhjen e 244-të, të mbajtur më datë 21 dhjetor 2020, merr këtë:

VENDIM

I. Znj. Afërdita Bytyqi, gjyqtare/kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë, përzgjedhet dhe caktohet gjyqtare në Departamentin Special në kuadër të Gjykatës së Apelit.

II. znj. Bytyqi, do të filloj punën në Departamentin Special në kuadër të Gjykatës së Apelit, më datë 1 janar 2021.

III. Vendimi hyn në fuqi me datë 21 dhjetor 2020.

Arsyetim

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në takimin e mbajtur me 21 dhjetor 2020, me qëllim të efikasitetit të punës së departamentit special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit, ka shpallur konkurs të brendshëm për nëntë (9) pozita të lira për gjyqtarë, të cilët do të ushtrojnë funksionimin e tyre në kuadër të këtij departamenti, tri (3) pozita për departamentin special në kuadër të Gjykatës së Apelit dhe gjashtë (6) pozita për departamentin special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, një prej tyre nga radhët e komunitetit jo shumicë.

Komisioni për Përzgjedhjen e Gjyqtarëve të Departamentit Special, pas zhvillimit të procesit të intervistimit dhe vlerësimit të të gjithë kandidatëve, konform Rregullores Nr. 03/2019 për

Organizimin dhe Funksionalizimin e Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit, i rekomandoi Këshillit Gjyqësor të Kosovës, kandidatët për gjyqtarë në Departament Special, në mesin e të cilëve edhe znj. Afërdita Bytyqi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, pas shqyrtimit të rekomandimeve të komisionit, si dhe pas votimit për secilin kandidat të rekomanduar nga komisioni, në takimin e mbajtur më 21 dhjetor 2020, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Skender OÇAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- *Znj. Afërdita Bytyqi;*
- *Kryetarit të Gjykatës së Apelit;*
- *Ud Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë;*
- *Sekretariatit të KGJK-së, si dhe*
- *Arkivit.*